

Njoftim i përqendrimit me të cilin Nipon Ekspres Holdings, Ink. (Nippon Express Holdings, Inc.), .
Tokio, Japoni fiton kontrollin e SH HoldKo GmbH (SH HoldCo GmbH), Karlsruhe, Gjermani

(lënda nr. 08-150/2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), me datë 12.11.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka pranuar njoftimin për përqendrim me të cilin Nipon Ekspres Holdings, Ink. (Nippon Express Holdings, Inc.), me seli në Ndërtesën e Grupit EnEks , Kanda, Izumiço 2. , Çijoda-ku, 101-0024 Tokio, Japoni, ("EnEx", së bashku me shoqëritë e saj të varura nën kontroll: "EnEks Group") synon të fitojë kontroll të pavarur mbi Grupin e Kompanive Simon Hegele („**Simon Hegele Group**“) duke blerë të gjithë pjesët në SH HoldKo GmbH (SH HoldCo GmbH), me seli në Haid-und-Hoj-Str. 13-15, 76131, Karlsruhe, Gjermani..

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

EnEks është një kompani japoneze me bazë në Tokio, e cila kuoton në Bursën e Tokios. Ajo operon në mbarë botën (në Japoni, Amerikën Jugore dhe Veriore, Evropë, Azinë Lindore dhe Azinë Jugore dhe Oqeani) si një ofrues global i shërbimeve logjistike, duke përfshirë shërbimet e magazinimit, transportin vendas dhe ndërkombëtar me hekurudhë, det ose ajër.

Produktet dhe shërbimet e EnEks janë pjesë integrale e katër segmenteve për të cilat mund të raportohet, përkatësisht logjistika, transporti i sigurt, transporti i mallrave të rënda dhe ndërtimi, si dhe mbështetja logjistike

Në Maqedoninë e Veriut, EnEks ka një shoqëri të varur të regjistruar:

KARGO-PARTNER LOGISTIKS SHPKNJP Shkup (me seli në rr. Orce Nikolov nr. 111/1-1, 1000 Shkup, dhe aktiviteti i regjistruar 52.29 – Veprimtari të tjera të ndërlidhura në transport).

Grupi Simon Hegele është një ofrues aktiv global i shërbimeve dhe logjistikës me fokus në sektorin e kujdesit shëndetësor, i vendosur kryesisht në Gjermani dhe në një masë më të vogël në Francë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Meksikë, Australi, Brazil, Singapor, dhe Turqisë. Grupi Simon Hegele nuk është aspak i pranishëm në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant i mallrave mund të përkufizohet si tregu i logjistikës me kontratë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

15.11. 2024

Shkup